

REPUBLIKA E KOSOVES  
KOMUNA LIPJAN  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

Pranuar më: Priljmeno: 22.06 2022		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
15-020/01-32496		



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, nenit 10 pika 1.3 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane 15Nr.020-63687 të datës 24.06.2019, bazuar në mbledhjen e Komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale të mbajtur me datë 22.06.2022, komisioni nxjerr këtë:

**VENDIM**  
**PËR PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË AKTIVITETEVE PËR ZGJEDHJEN E**  
**KËSHILLAVE DHE KRYETARËVE TË KËSHILLAVE LOKALE TË FSHATRAVE DHE**  
**LAGJEVE URBANE**

I. PEZULLOHEN, përkohësisht të gjitha aktivitetet e mbetura nga data 23.06.2022 për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave dhe lagjeve urbane për shkak të mungesës së qytetarëve në marrjen pjesë në aktivitetet e organizimit të zgjedhjeve këshillave dhe kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave dhe lagjeve urbane për shkak që tani gjendemi në kohën e pushimeve verore .

II. Andaj në bazë të ankesave të qytetarëve për kohën të papërshtatëshme të mbajtjes së zgjedhjeve dhe duke marrë parasysh anulimin e disa takimeve të parapara në agjendë, komisioni vendosi për pezullim të zgjedhjeve si në pikën I.

III. Pas përfundimit të pushimeve verore arsye që ka shkaktuar marrjen e këtij Vendimi. Komisioni do të njoftoj me kohë për orarin e ri të vazhdimin të mbajtjes së tubimeve nëpër fshatra dhe lagje urbane për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave dhe lagjeve urbane.

IV. Vendimi hyn në fuqi nga data 23.06.2022

Lipjan më 22.06.2022

Kryesuesja e Komisionit  
Majlinda Sylejmani

